

Prof. Asoc. Dr. Dilina Beshiri

Pedagoge dhe studiuese në fushën e shkencave të edukimit, aktualisht Professore e Asociuar në Departamentin e Pedagogjisë, pranë Fakultetit të Edukimit në Universiteti Aleksandër Moisiu.



Ka kryer studimet doktorale në Shkenca Edukimi, pranë Universiteti të Barit, Itali. Veprimtaria e saj kërkimore dhe akademike përqendrohet në pedagogjinë sociale, politikat arsimore dhe lidërsipin në arsim, me fokus të veçantë në proceset e transformimit dhe modernizimit të arsimit të lartë. Kontributi i saj përfshin zhvillimin dhe inovacionin e kurrikulave, promovimin e mikrokrediteve si forma bashkëkohore të të nxënës gjatë gjithë jetës, si dhe avancimin e proceseve të ndërkombëtarizimit të institucioneve të arsimit të lartë përmes angazhimit aktiv në projekte dhe iniciativa kombëtare e evropiane.

Përveç veprimtarisë universitare, Prof. Asoc. Dr. Beshiri kontribuon si eksperte e jashtme pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në proceset e vlerësimit, monitorimit dhe akreditimit të programeve të studimit në fushën e arsimit. Gjithashtu, ajo është e angazhuar si trajnere në Shkollë e Drejtorëve, ku kontribuon në forcimin e kapaciteteve profesionale të drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar.

Phd. Cand Megi Tirana



Pedagoge universitare, studiuese, përkthyesë dhe trajnere me mbi 15 vite përvojë në arsimin e lartë, komunikimin shumëgjuhësh dhe zhvillimin profesional. Ajo ushtron detyrën e Lektorese së Anglishtes në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës dhe është kandidatë për Doktoraturë në Shkencat e Edukimit, ku kërkimi i saj fokusohet në ndikimin e mirëqenies së stafit akademik në zhvillimin e inteligjencës emocionale të studentëve në arsimin e lartë.

Puna e saj ndërthur edukimin, inteligjencën emocionale, kreativitetin dhe zhvillimin e potencialit njerëzor. Megi ka prezantuar dhe publikuar studime shkencore mbi inovacionin në arsim, mirëqenien, edukimin mediatik dhe aftësitë e buta në konferenca dhe revista akademike ndërkombëtare. Ajo ka qenë pjesëmarrëse në programe Erasmus+ në Suedi dhe Francë, duke kontribuar në iniciativa ndërkombëtare mbi kuriozitetin, kreativitetin dhe zhvillimin akademik.

Paralelisht me karrierën akademike, ajo ka një eksperiencë të gjerë si përkthyesë dhe interprete për institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe si themeluese dhe drejtuese e një qendre trajnimi dhe edukimi.

Prof. Maria Augusta Romão Da Veiga (Lektore e ftuar)



Profesore Koordinatore në Shkollën e Edukimit të Institutit Politeknik të Bragançës, Portugali, me mbi 29 vite përvojë në fushën e edukimit emocional dhe zhvillimit të kompetencës emocionale. Ajo është krijuese e Shkallës së Kompetencës Emocionale EVCEr33 (Emotional Competence Veiga Scale), e hartuar fillimisht në vitin 2001 dhe e përdorur e validuar në gjashtë vende. Në vitin 2018, përfaqësoi Portugalinë në Parlamentin Europian me kërkime në fushën e kompetencës emocionale, edukimit emocional dhe inteligjencës emocionale. Aktualisht koordinon Programin Intensiv të Kombinuar (Blended Intensive Programme) në Edukimin Emocional, si dhe Njësinë Ekstrakurrikulare në Edukimin Emocional në Institutin Politeknik të Bragançës. Veprimtaria e saj akademike dhe kërkimore fokusohet në zhvillimin e kompetencës emocionale dhe promovimin e edukimit emocional në kontekste të ndryshme arsimore.